

## **RELACION TEKNIK ELEKTRIK**

Ndertim I shkolles 9-vjecare ne fshatin Darezeze, Nj.Administrative Dermenas,Fier  
Sistemi Elektrik

- 1.1 Hyrje dhe shenime mbi materialet e perdonura
- 1.2 Furnizimi me energji elektrike
- 1.3 Paneli kryesor i tensionit te ulet
- 1.4 Rrjeti i shperndarjes se tensionit te ulet
- 1.5 Rrjeti i ndriçimit te brendshem
- 1.6 Ndriçimi i brendshem i emergences
- 1.7 Tokezimi
- 1.8 Shkarkimet atmosferike

### **1.1 Hyrje**

Projektet elektrike duhet te respektojne te gjitha konditat projektuese dhe standartet qe jane sot ne fuqi ne Shqiperi (KTP – STASH) dhe per elemente special qe nuk parashikohen ne keto standarte duhet ti referohemi Euro norms (EN), dhe Eurostandarteve (EN, ED) dhe rekondimeve te CEI, CENELEC, DIN, VDI/VDE.

#### **1.1.1 Shenime teknike mbi materialet e perdonura.**

Ne keto projekte jane parashikuar materiale dhe pajisje te prodhua ne vendet e BE dhe me minimumi 3 vjet garanci .

Ketu jane dhene kerkesat e pergjithshme si dhe kondita teknike te instalimit te nevojshme per te gjithe aksesoret dhe instalimet elektrike ne per gjithesi.

Keto kerkesa te pergjithshme do te plotesohen sikurse jane treguar ne skicat dhe projektet si dhe pershkrimet apo instruksioneve te projektit.

#### **1.1.2 Objekti i punimeve**

Punimet qe permabahen ne projekt i perkasin furnizimit dhe venies ne pune te impiantit elektrik te nevojshem. Objekti i ketij relacioni teknik jane edhe normat dhe pershkrimet qe lidhen me furnizimin dhe venien ne pune te pjeseve kryesore dhe aksesoreve te nevojshem per realizimin e ketyre impianteve te ndara si me poshte:

- Impianti i furnizimit me energji elektrike te godines dhe nevojave te tjera.
- Paneli kryesor dhe panelet e tjera
- Impianti i furnizimit te paneleve
- Impianti i shperndarjes te rrjetit elektrik te godines,ndricim,priza fuqie.
- Impianti i tokezimit

#### **1.1.3 Konfigurimi i impianteve**

Konfigurimi i impianteve eshte ofruar nepermjet:

- Vizatimeve te projektit dhe planimetrike te plota ne seksione dhe ne shkalle
- Skemat elektrike te plota te impianteve te kontrolluara sipas normave
- Panelet e komandimit
- Relacioni teknik

Eshte e rendesishme te theksohet qe parashikimi i zgjedhjes dhe llogaritjes se pajisjeve te perdonura ne kete projekt eshte bere duke u mbeshtetur ne normat CE.

Eshte respektuar ne menyre rigoroz te teknologja ne baze te se ciles jane vendosur pajisjet elektrike, te cilat ne vizatim Jane paraqitur me simbolet perkates.

Ne veçanti eshte bere kujdes gjate projektit ne zgjidhjen korrekte e ne menyre funksionale e ekonomike te te gjitha pajisjeve elektrike te vodosura ne secilin prej ambienteve te nderteses.

#### 1.1.4 Cilesia e materialit dhe vendi i insatalimit

Te gjithe materialet dhe aparatet qe do te perdoren ne impiantet elektrike duhet te pershtaten me ambientin ku jane instaluar dhe duhet te kene karakteristika te tilla qe tu rezistojne veprimeve mekanike, gerryese, termike ose lageshtise dhe agjenteve te tjere ndaj te cileve mund te ekspozohen gjate punes. Te gjithe materialet dhe aparaturat duhet tu perqigjen Normave CE. Rekomandohet ne zgjedhjen e materialeve, preferanca e prodhimeve europiane. Te gjitha materialet duhet te kene te dhenat targen dhe instrukzionet e mundeshme te perdonimit qe perdonin simbolet e CE.

#### 1.1.5 Tubat mbrojtës – Pershkrimi i tubave- Kutite e degezimit

Percjellesat perveç rasteve kur flitet per instalimet ajrore duhet te jene gjithmone te mbrojtur dhe te mbuluar mekanikisht.Keto mbrojtje mund te jene ; tuba, kanale mbajtes kabllosh, kalime, tubacione ose gropë ne strukturat e ndertimit etj. Ne impiantet dhe ne godinat civile duhen te zbatohen keto rregulla: Diametri i brendeshem i tubave duhet te jete te pakten 1,3 here diametrin e rrerhit te jashteshkruar tufes se kabllave te futura ne te dhe nuk duhet te permbaje kabllot per rrjetet e dedektimit te zjarri, rrjeti LAN dhe te telefonise.Ky koeficjent i zmadhimit duhet te rritet deri ne 1,5 kur kabllot jane te tipit te plumbuar ose me veshje metalike;diametri i tubit duhet te jete aq i madh sa te futen e te rifuten me lehtesi ne te kabllot ne menyre qe te mos demtohen as kabllot as tubat. Megjithate diametri brendeshem nuk duhet te jete me i vogel se 14mm;Kurbat duhet te kryhen me rakordime ose me pendenca qe nuk demtojne tubat ose bllokajne kalimin e kabllave;Ne çdo kthese te forte eshte e nevojshme struktura murale e objektit dhe per çdo devijim nga vija kryesore dhe sekondare ne çdo objekt qofte, tubi duhet te nderpritet me kuti degezimi; bashkimet e percjellesave duhen te kryhen ne kutite e degezimit duke perdonur morsetat shtrenguese qe duhen; Kutite e degezimit duhet te jene te tilla qe gjate instalimit te mos jete e mundur nderhyrja e trupave te huaj dhe te kryhet shperndarja e nxehtesise qe prodhohet ne to.Mbulesa e kutive duhet te jete e garantuar me fiksim dhe e hapshme vetem me vegla te posaçme.

Keshtu eshte pranuar te vendosen kabllo ne te njejtin tub dhe ne te njejten kuti,perderisa nuk jane te izoluar per tensione me te rritur dhe kutite e veçanta te jene te pajisura me membrane, qe mund te hiqet vetem me veglat perkatese ndermjet morsetave te destinuara per te shtrenguar percjellesa qe u perkasin sistemeve te ndryshem.Tubat mbrojtës te percjellesave elektrike te vodosur ne ulluk, qe nuk kalojne ne kanalizime te tjera duhet te vendosen ne menyre qe te mos jene subjekt I influencave demtuese qe kane te bejne me mbingrohjen, lageshtirene dhe formimin e kondesimit, etj.

#### 1.1.6 Kabllo dhe percjellesa

Per te realizuar impiantet elektrike ne ndertimet publike jane zgjedhur tipet e meposhtme te kabllave (percjellesave ne degezime)

Ne brendesi te nderteses :

1. N07V-K: percjelles njepolar i izoluar me pvc, ne rastin e instalimit te fshehur ne tuba nen suva.
2. FR-OR 450/750V; percjelles shumepolar me izolim e guaine pvc, ne rastin e furnizimit te linjave me seksion deri 6mm<sup>2</sup>, ne kanalina.
3. FG7-OR 450/750V; percjelles shumepolar me izolim e guaine pvc, ne rastin e furnizimit te linjave me seksion mbi 10 mm<sup>2</sup>, ne kanalina apo ne tuba ne rastet e instalime te jashtme ne toke.
4. N1VV-K; percjelles njepolar ose shumepolar me izolim e guajne ne pvc ne rastin e sistemit MKZ.

#### 1.1.7 Izolimi i Kabllove

a) Kabllot e perdorur ne sistemet e kategorise se pare duhet te jene te pershtatur me tension nominal kundrejt tokes dhe tension (U<sub>0</sub>/U) jo me te vogel se 450/750V, ndersa ato qe perdoren ne sistemet e sinjalizimit dhe te komandas jo me te vogel se 300/350 U<sub>0</sub> =tensioni nominal ndaj tokes. U tensioni nominal

b) Ngjyrat dalluese te kabllove

Percjellesat qe perdoren ne realizimin e impianteve elektrike duhet te shenohen me ngjyrat e parashikuara ne tabelat unifikuese . Ne veçanti duhet te perdoret dy ngjyreshi jeshil-i gjelbert per percjellesit e mbrojtjes e ekvipotenciale, dhe blu i hapur per percjellesin e neutrit. Norma nuk percakton ngjyrat e veçanta per percjellesit e fazes por ato duhen shenuar ne menyre te njejte per te gjithe impiantin nga ngjyrat e zeze, gri dhe kafe.

c) Seksionet minimale dhe renia e lejuar e tensionit

Seksoni i percjellesave llogaritet ne baze te fuqise dhe gjatesise se qarkut (duhet qe renia e tensionit te mos kaloje 4% te vleres se tensionit ne boshlek). Seksioni I percjellesit zgjidhet ndermjet vlerave te unifikuara. Ne çdo rast nuk duhet te kalohen vlerat e dhena te rrimes se lejuar, per tipe te ndryshem percjellesish, nga tabelat e unifikimit

Seksionet minimale te lejuara jane:

0,75-1mm<sup>2</sup> per qarqet e sinjalizimit dhe te telekomandes :

1,5 mm<sup>2</sup> per qarqet e ndriçimit baze, aparate te ndriçimit dhe aparate me fuqi me te vogel ose te barabarte me 2.2kW:

2,5mm<sup>2</sup> per qarqet fuqia e te cilave eshte me e vogel ose e barabarte me 3kW:

4mm<sup>2</sup> per linjat e veçanta qe ushqejne aparate te veçante me fuqi nominale me te madhe se 3kW:

d) Seksioni minimal i percjellesave te neutrit

Seksoni i percellesit te neutrit nuk duhet te jete me i vogel se ai I percjellesave korrespondues te fazes. Per percjellesa te qarqeve me shume faze, me seksion me te madh se 16mm<sup>2</sup> (per percjellesa bakri ) duhen kenaqur kushtet e normale CE.

e) Seksioni i percjellesave te tokes dhe te mbrojtjes

Seksoni i percjellesave te tokes dhe te mbrojtjes, pra te percjellesave qe lidhin me impiantin e tokezimit pjeset qe duhet te mbrohen nga kontaktet direkte, nuk duhet te jete me i vogel se sa tregohet ne normen CEI 64-8:seksoni minimal i percjellesit te tokes duhet te jete jo me i vogel se ai I percjellesit te mbrojtjes me keto minimume perkatese:

I mbrojtur nga gerryerjet por jo mekanikisht 16(CU) 16(FE)

I pa mbrojtur nga gerryerjet 52(CU) 50(FE)

Numri maksimal i kabllove njepolare qe mund te futen ne tubat mbrojttes

Diametri I  
Jashtem

Diametri i  
brendshem (mm)

Seksoni I percjellesve  
mm<sup>2</sup>

(mm)		
20	14.1	(9 7,4,4,2
25	18.3	(12 9,7,4,4,2
32	24.3	12 9,7,7,3

Qarqet me seksion  $1,5\text{mm}^2$  jane te mbrojtura nga mbingarkesat nga nje automat me rryme nominale 10A , ndersa qarqet me seksion  $2,5\text{mm}^2$  jane te mbrojtura me nje automat me rryme nominale 16 A, ato me  $4\text{mm}^2$  me automat 20A.Linjat, duke qene te mbrojtura nga mbingarkesat, jane gjithashtu te mbrojtura edhe per nje lidhje te shkurter ne fund te se njejtes linje.

Eshte e rendesishme qe rryma nominale e automatit mbrojtes te mos kaloje rrymen nominale te paisjeve.

#### 1.1.8 Renia e tensionit

Seksoni i percjellesave i llogaritur ne funksion te fuqise se punes dhe nga gjatesia e qarkut (ne menyre qe renia e tensionit te mos kaloje 4% te tensionit ne (boshllek) duhet te zgjidhet nepermjet atyre te unifikuara.

#### 1.1.9 Rezistenca e izolimit

Per te gjitha pjeset e impiantit qe perfshihen midis dy siguresave ose automateve te njepasnjeshem, ose te vendosura para sigureses ose para automatit te fundit,rezistenca e izolimit kundrejt tokes ose ndermjet percjellesve qe u perkasin fazave me polaritet te ndryshem duhet te jete me e madhe se; $500\text{ ohm}$  per sisteme me tension nominal kundrejt tokes qe perfshihen nga  $50\text{V}$  deri ne  $500\text{V}$ .

$250\text{ ohm}$  per sisteme me tension nominal kundrejt tokes me te vogel se  $50\text{V}$

#### 1.1.10 Fuqia e çkyçjes

Paisjet e seksionimit te perdorura ne nivelin e kontatoreve, duhet te llogariten me nje rryme te lidhjes se shkurter te pakten  $10\text{kA}$  per çkyçesat trefazore dhe per ata nje fazore.

Eshte bere zgjedhja e tipit dhe llogaritja e seksionit te percjellesave ne baze te fuqise se pajisjes qe do te ushqeqe dhe automateve per secilin qark te furnizimit te pajisjeve elektrike sipas normave perkatese. Te respektohen vlerat dhe karakteristikat e pajisjeve sips vizatimeve te kuadrove elektrike.

#### 1.2 Furnizimi me energji

Furnizimi me energji elektrike do te behet te behet nga linja e TU te OSHEE sipas vendit te percaktuar nga furnizuesi (OSHEE). Keshtu ajo do ti sherbeje te gjithe objektit dhe percaktimi i fuqise llogariteze do te behet ne baze te kerkeses se konsumatoreve .

Duke qene se furnizimi me energji do te behet nga linja elektrike TU kjo linje do te furnizoje kuadrin kryesor te objektit qe eshte zgjedhur te vendoset ne katin perdhe ne pjesen hyrese te objektit.

#### 1.3 Shperndarja kryesore ne tension te ulet.

Kuadri shperndares kryesor e tensionit te ulet do te instalohet nga kontraktori ne katin perdhe. Siguria ndaj renies nen tension ne kuadrin kryesor te shperndarjes se tensionit te ulet do te realizohet me ane te paneleve izolues ne pjesen ballore te kuadrit.Siguria ndaj renies nen tension

ne kuadrot e ndryshme te nenshperndarjes do te realizohet me ane te releve diferenciale sipas skemave te kuadrove te paraqitura ne vizatim.

Per te gjitha linjat dalese percjells i neutralit ndahet nga percjells i tokezimit (sistemi TNS).

Kabllot dalese nga kuadri kryesor ne tension te ulet duhet te lidhen drejtperdrejt me komponenetet e kuadrit.Kabllot duhet te instalohen (perfshire gjithe suportet e kabllove) nga kuadri kryesor ne tension te ulet per ne te gjitha panelet e nenshperndarjes

### 1.5 Ndricimi I pergjithshem

Ndricimi I brendshem duhet te jete ne perputhje me EN 12464-1/2002.

Ndricuesit ne te gjithe e ambjentet jane te mbrojtura nga verbimi qe do te thote se ndricimi e ndricuesve ne lartesine me te larte se  $65^{\circ}$  perreth ndricuesit eshte me e ulet se  $1000 \text{ cd/m}^2$ .

Faktori reduktues 0,80.

Gjithe ndricuesit duhet te pajisen me drosela me humbje te vogla.Te gjithe ndricuesit duhet te paisen me klema (min. pjesa  $2,5\text{mm}^2$ ) dhe klema shtese per tu lidhur me nje ndricues vijues. Te gjithe ndricuesit e brendshem jane te paisur me llampa tub floreshente, spote me llampa fluoreshente kompakte.

Llojet e ndricuesve:

Kontraktori duhet te beje llogaritjet e duhura per ndricuesit ne lidhje me prodhimet e ofruara.

### 1.6 Ndricimi i brendshem i emergjences

Ndricimi i daljes dhe ai i emergjences duhet te behet ne perputhje me EN1838.

Ndricuesit e daljes dhe ato te emergjences jane te instaluar ne siperfaqe, min. $1x11\text{W}$ , me bateri te brendshme (autonomia minimale 2 ore, maksimumi i kohes se karikimit 12 ore) dhe paisje elektronike.

Ndricuesit e daljes jane gjithmone te ndezur dhe jane te paisur me nje shenje te gjelber (shenja paraqet nje njeri me nje shigjete dhe nje dere ne drejtimin qe duhet te largohen njerezit) Ndricuesit e emergjences jane gjithmone te ndezur.

### 1.7 Tokezimi

Impianti I tokezimit do te realizohet me elektroda standarte profil "L" te nikeluara  $h=1.5\text{m}$  ( $50x50x5$ ).Elektrodat e tokezimit do te lidhen ndermjet tyre ne formen e nje konturi te mbyllur ne distance jo me pak se  $3\text{m}$ .Thellesia e vendosjes se elektrodave jo me pak se  $50\text{cm}$  nga kuota  $0.00$  e tokes.Konturi I tokezimit do te behet me percjelles tokezimi Cu.Bashkimi I percjellesit te tokezimit me elektrodat do te behet me morseta shtrenguese ne menyre qe percjellesi I tokezimit duke kaluar nga nje elektrode ne tjetren te mos shkeputet.pas montimit te impiantit te tokezimit duhet te behet matja e rezistences se tokezimit e cila duhet te jete Brenda kushteve te sigurimit teknik me e vogel se  $4 \text{ ohm}$ .Numri I elektrodave varet nga kushti qe rezistenca e tokezimit te jete Brenda normave ne te kundert shtohet numri I elektrodave derisa te arrihet vlera e kerkuar.

Punoi:Ing. Elektrik Raimonda Xhafa